



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

35/20

26.02.2020

PRISTINE - PRISTINA

PSH .nr.35/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të z. Goran Milenković - Kryetar, z. Nuhi Paçarizi – Referues, z. Blerim Dina - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: OE “LEGO”-Prishtinë (për LOT 1), kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit, me titull: “Furnizim me pajisje mjekësore për QKMF DHE QMU RI-TENDER LOT-1”, me nr. të prokurimit: 616-19-8612-1-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ – Kuvendi Komunal Prishtinë, më datën: 12.02.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: “LEGO”-Prishtinë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me pajisje mjekësore për QKMF DHE QMU RI-TENDER LOT-1”, me nr. të prokurimit: 616-19-8612-1-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ – Kuvendi Komunal Prishtinë

II. ANULOHET, njoftimi për anulim të aktivitetit, lidhur me aktivitetin të prokurimit me titull: “Furnizim me pajisje mjekësore për QKMF DHE QMU RI-TENDER LOT-1”, me nr. të prokurimit: 616-19-8612-1-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ – Kuvendi Komunal Prishtinë, dhe lënda kthehet në rivlerësim.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej **15** ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues: “LEGO”-Prishtinë ,aprovohet si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues OE “LEGO”-Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 15.01.2020 me nr 35/20, kundër njoftimit për anulim të aktivitetit me titull: “Furnizim me pajisje mjekësore për QKMF DHE QMU RI-TENDER LOT-1”, me nr. të prokurimit: 616-19-8612-1-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ – Kuvendi Komunal Prishtinë, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 1, 7, 59, 60, 62 dhe 69 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës si dhe nenin 44.5 të RRUOPP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 22.01.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 31.01.2020, Eksperti shqyrtues sqaron si në vijim:

Përgjigje në Pretendimi numër 1:

Pretendimi kryesor ankimorë sipas ankesës nr.35/20 është se AK-KK Prishtinë padrejtësisht e ka eliminuar OE ankues, me arsyetim se i njëjti nuk plotëson kërkesat e dosjes së tenderit “nuk ka ofruar dëshmi të mjaftueshme për furnizime të ngjashme në vlerën e kërkuar”.

Sipas dosjes së tenderit (shih më lart rubrikën “faktet e rastit”), vlera minimale e kërkuar për **kontrata të ngjashme** për Lot.1 ka qenë 100.000€.

OE ankues ka ofruar listën e kontratave të përfunduara si dhe dëshmitë – referencat.

Në listë të OE ankues janë katër kontrata, prej të cilave vetëm kontrata me numër rendor 1 konsiderojmë se nuk është kontratë e ngjashme me këtë aktivitet të prokurimit, më saktësisht kontrata:

1 **Furnizim me barna** nga L.E. 11.10.2016 11.10.2018 89,300.00 € Ministria e Shëndetësisë
Kontratat tjera për të cilat vlerësojmë se janë **kontrata të ngjashme** dhe në pajtim me kërkesën e AK janë:

Furnizim me medikamente, paisje	04.01.2018 04.01.2019 85,000.00€	Spitali
2 mjekësore dhe material shpenzues medicinal, lab oratorik		ALOKA

3	Furnizim me medikamente, paisje mjekesore dhe material shpenzues medicinal,lab oratorik	05.01.2018	05.01.2019	70,000.00€	Vita Hospital
4	Furnizim me medikamente, paisje mjekesore dhe material shpenzues medicinal,lab oratorik	08.01.2018	08.01.2019	80,000.00€	N.T.SH. Spitali Lindja

Shuma totale e këtyre tri referencave është 235,000.00€, shumë kjo e cila plotëson dhe tejkalon kërkesën e AK-së.

Në rast se AK-KK Prishtinë ka pasur dyshime për vërtetësinë e këtyre referencave (siç ka lënë të kuptohet përmes vendimit për refuzim të kërkesës për rishqyrtim), të njëjtat referenca konform nenit 52.7 dhe 59.2 të LPP-së ka mundur ti verifikoj përmes subjekteve që kanë bërë lëshimin e tyre.

Bazuar në gjitha këto që u cekën si më lartë konsiderojmë se, pretendimi ankimorë i OE ankues është i bazuar dhe se AK-KK Prishtinë me rastin e vlerësimit ka bërë shkelje të pikës 9.1 dhe 9.2 të dosjes së tenderit si dhe shkelje të nenit 52.7 të LPP-së.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, ndërsa të anulohet vendimin i AK-së për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe lënda të kthehet në Rivlerësim

Operatori ekonomik përmes parashtresës me shkrim të datës: 03.02.2020, ka njoftuar OSHP-në se pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Autoriteti Kontraktues përmes parashtresës me shkrim të datës 03.02.2020 ka njoftuar OSHP-në se nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës: 12.02.2020, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtues, përfaqësuesi i OE ankues,përfaqësuesi i AK-së si dhe eksperti shqyrtues, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi mbi dhënien e kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertizës të OSHP-së, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE-së ankues z. Fetoshi deklaroj: Të nderuar AK-ja na ka dërguar njoftimin mbi vendimin me dt.26.12.2019 ku e ka anuluar aktivitetin e prokurimit për Lot I, me arsyetimin se

nuk ka asnjë ofertues të përgjegjshëm, ndërsa neve na ka eliminuar me arsyetimin se “nuk kemi dorëzuar dëshmi të mjaftueshme se kemi përfunduar kontrata të ngjashme në shumën e kërkuar nga AK në tri vitet e fundit duke filluar nga data e publikimit”.

Kjo arsye e eliminimit është plotësisht e pabazuar sepse ne kemi ofruar dëshmi të mjaftueshme se kemi realizuar kontrata në vlerë minimale prej 100,000.00 Euro për LOT I, madje ne kemi ofruar dëshmi se e kemi tejkaluar këtë vlerë të kërkuar në nenin 9.1&9.2 të FDT-së. Ju lutem të shikoni listën e kontratave dhe referencat të cilat i kemi bashkangjitur sepse ne kemi ofruar dëshmi konkrete dhe të mjaftueshme për tu shpallur fitues i këtij Loti.

Autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit ka vepruar në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së dhe në kundërshtim edhe me nenin 44.5 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik (RRUOPP), sepse asnjëri nga kushtet e parashikuara në këto dispozita nuk janë përmbushur në këtë rast, sepse ne i plotësojmë të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë, prandaj është dashur të shpалleshim si operator ekonomik i përgjegjshëm dhe natyrisht edhe fitues i këtij tenderi.

Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë rezulton se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së. AK-ja me këtë vlerësim dhe vendim na ka diskriminuar neve në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së sepse nuk na ka rekomanduar për kontratë edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë.

Ne pajtohemi me konstatimet e ekspertit shqyrtues i cili e ka analizuar në detaje ofertën tonë, konkretisht kontratat dhe referencat që ne i posedojmë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesja e AK-së znj. Dalipi e cila deklaroj: Autoriteti Kontraktues rekomandon panelin që të hedh poshtë ankesën e OE ankues. OE ankues është eliminuar se nuk ka kryer kontrata në 3 vitet e fundit. OE ka ofruar dëshmi mirëpo të gjitha ato dëshmi janë për materiale shpenzuese dhe asnjë nuk është për pajisje mjekësore, EO ka referenca dhe janë materiale shpenzuese. OE ka ofertuar vetëm për Barna dhe materiale shpenzuese. I dorëzoj panelit kopjet e referencave

Gjatë prezantimit në seancë Eksperti Shqyrtues z. Halili deklaroj: Prej 4 Referencave të ofruara nga OE ankues, Referenca me nr 1 Furnizim me barna edhe në raport e kam konstatuar se nuk është si në kërkesë, po ashtu edhe 3 referenca tjera janë furnizim me medikamente, pajisje mjekësore dhe material shpenzues medicinal, laboratorim në Spitalin Aloka në vlerë 85.000 euro.

E dyta Furnizim me medikamente, pajisje mjekësore furnizim me material shpenzues me Spitalin Vita në vlerë të 70.000 euro,

E treta Furnizim me pajisje mjekësore dhe material shpenzues me Spitalin Lindja në vlerë të 80.000 euro. Nga vet titujt konsiderojmë se këto janë të ngjashme. Qëndroj mbrapa ekspertizës.

Ne arsyetim te eliminimit kanë thënë se i njëjti nuk ka ofruar dëshmi për furnizime te ngjashme, kërkesa nuk është furnizime por kontrata te ngjashme.

Përfaqësuesja e AK-së shtoj: Është e vërtet se titulli është ashtu por ne ofertë te OE ne asnjë pozicion nuk ka pajisje mjekësore

Përfaqësuesi i OE-se shtoj: Këtu vetëm një gjë duhet te jete e qarët nuk është kërkuar kontrata te njëjta është kërkuar te ngjashme është një term me i gjere, këtu ka edhe kontrata te pajisjeve mjekësore.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE-së z. Fetoshi deklaroj: Kërkojmë nga paneli shqyrtues që të aprovohet ankesa jonë si e bazuar dhe që ky aktivitet i prokurimit të kthehet në rivlerësim.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesja e AK-së znj. Dalipi deklaroj: kërkojmë nga paneli shqyrtues te hedhe poshtë ankesën e OE si te pa bazuar dhe te mbetet ne fuqi vendimi i Autoritetit Kontraktues.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se ankesa është parashtruar kundër njoftimit për anulim te aktivitetit te prokurimit.

Lidhur me pretendimin se AK-KK Prishtinë padrejtësisht e ka eliminuar OE ankues, me arsyetim se i njëjti nuk plotëson kërkesat e dosjes së tenderit “nuk ka ofruar dëshmi te mjaftueshme për furnizime te ngjashme ne vlerën e kërkuar”, Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional të prokurimit sqaron se sipas dosjes së tenderit, vlera minimale e kërkuar për **kontrata të ngjashme** për Lot.1 ka qenë 100.000 €.

OE ankues ka ofruar listën e kontratave të përfunduara si dhe dëshmitë – referencat.

Në listë të OE ankues janë katër kontrata, prej të cilave vetëm kontrata me numër rendor 1 konsiderojmë se nuk është kontratë e ngjashme me këtë aktivitet të prokurimit, më saktësisht kontrata:

1 Furnizim me barna nga L.E. 11.10.2016 11.10.2018 89,300.00 € Ministria e Shendetesise

Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional të prokurimit sqaron se Kontratat tjera janë **kontrata të ngjashme** dhe në pajtim me kërkesën e AK janë:

2	Furnizim me medikamente, pajisje mjekësore dhe material shpenzues medicinal,lab oratorik	04.01.2018	04.01.2019	85,000.00€	Spitali ALOKA
3	Furnizim me medikamente, pajisje mjekësore dhe material shpenzues medicinal,lab oratorik	05.01.2018	05.01.2019	70,000.00€	Vita Hospital
4	Furnizim me medikamente, pajisje mjekësore dhe material shpenzues medicinal,lab oratorik	08.01.2018	08.01.2019	80,000.00€	N.T.SH. Spitali Lindja

Shuma totale e këtyre tri referencave është 235,000.00€, shumë kjo e cila plotëson dhe tejkalon kërkesën e AK-së.

Bazuar në gjitha këto që u cekën si më lartë Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional të prokurimit sqaron se pretendimi ankimorë i OE ankues është i bazuar dhe se AK-KK Prishtinë me rastin e vlerësimit ka bërë shkelje të pikës 9.1 dhe 9.2 të dosjes së tenderit si dhe shkelje të nenit 52.7 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

z. Goran Milenković

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK - Kuvendi Komunal Prishtinë

1x1 OE – “LEGO”-Prishtinë

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.